



This project is funded by  
the European Union



BASHKIA VAU DEJES

Njoftim

## Thirrje të hapur për Aplikime

Nr. 1489 Prot

Dt. 06.03.2024

Titulli i Projektit: **Vau Dejes si Destinacion Turizmi**

Akronimi i Projektit: **VDT**

Numri i marrëveshjes së ndihmës financiare: **2022/434-522**

Projekti "Vau Dejes si Destinacion Turizmi", i financuar nga Bashkimi Evropian, nga Programi Europeaid, sipas Marrëveshjes së Grantit Nr. 2022/434-522, ka parashikuar ofrimin e ndihmës financiare për palë të treta në formën e grantit, si një mjet për të arritur objektivat e vetë projektit.

Llojet e aktiviteteve që kualifikohen për të marrë mbështetje financiare janë ide biznesi të zbatueshme, apo ne fazën e zgjerimit në fushat e lidhur me turizmin:

- ✓ Shërbimet e hosteleve, shtëpive të mysafirëve, hoteleve
- ✓ Ofrimi i shërbimeve turistike në sporte dhe argëtim, udhëzime turistike, etj
- ✓ Ekonomitë kreative (përfshirë artizanatin tradicional)
- ✓ Prodhime lokale që shërbejnë për sektorin e hotelerisë

**Afati: 5 Prill 2024**

Koha e zbatimit të projektit është: **6 muaj**

Shuma minimale e ndihmës financiare për secilën palë të tretë: **5000 Euro**

Shuma maksimale e ndihmës financiare për secilën palë të tretë: **7000 Euro**

Kosto e panjohur në Projekt: **TVSH**

Gjuha në të cilën duhet të dorëzohet propozimi: **Gjuha shqipe**

Për tekstin e plotë të Guidës për Aplikantë, Formatin e Aplikimit dhe pyetjet mund të drejtoheni në adresën e emailit: **vdt@vaudejes.gov.al**.

Informacionet do t'i gjeni edhe në faqen zyrtare të Bashkisë: **www.vaudejes.gov.al** dhe atë të projektit **www.facebook.com/vaudejestourismdestination**





This project is funded by  
the European Union



BASHKIA VAU DEJËS

## Skema e Nën-Granteve THIRRJE PËR APLIKIME

### PROJEKT

“VAU DEJES- si destinacion turistik”

**Sipas thirrjes:** BE për zhvillim socio-ekonomik (si alternativë ndaj kultivimit dhe trafikimit të drogës) faza 2

**Europe Aid/173618/DD/ACT/AL**

Numri i Kontrates: **2022/434 - 522**

**VAU DEJES, Mars 2024**

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit të plotë: Prill 5, 2024 ora 16:00**

Në partneritet me:



**Centre for Competitiveness Promotion**  
**Qendra për Promovimin**  
**e Konkurrueshmerisë**



This Project is financed by the European Union

## Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje.....	4
1.1. Sfondi i projektit.....	4
1.2. Informacion i pergjithshem.....	5
1.3. Objektivi i thirrjes për aplikime.....	5
2. Rregullat për Thirrjen për Aplikime.....	6
2.1. Pranueshmëria e aplikantëve.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.2. Aktivitetet e pranueshme: aktivitete për të cilat mund të bëhet një aplikim.....	8
2.3. Kostot e lejuara.....	8
3. Si të aplikoni dhe procedurat që duhen ndjekur.....	9
3.1. Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve të plota.....	10
4. Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikacioneve.....	10
4.1. Hapat dhe kriteret.....	11
5. Njoftimi i vendimit të autoritetit nën-dhënës.....	12
5.1. Përmbajtja e vendimit.....	12
6. E drejta për ankim (procedurat e ankimit gjatë vlerësimit të veprimeve të propozuara.....	12
7. Kushtet për zbatimin pas vendimit të autoritetit dhënies për të dhënë një grant.....	13
8. Lista e dokumenteve dhe anekseve përkatëse.....	13



## **Shënim**

Kjo është një Thirrje e hapur për Aplikim, ku të gjitha dokumentet dorëzohen së bashku. Në radhë të parë, vetëm përshtatshmëria e aplikantëve do të kontrollohet në bazë të dokumenteve mbështetëse të kërkuara nga Autoriteti Grantdhënës. Ndërsa për aplikantët që janë përzgjedhur paraprakisht do të vlerësohet aplikacioni teknik. Udhëzimet e përshkruara në këtë dokument do t'i ndihmojnë të gjithë aplikantët të dorëzojnë me sukses aplikimet e tyre.

Ju mund të dërgoni një kërkesë për Paketën e Aplikimit duke dërguar një email në adresën: [vdt@vaudejes.gov.al](mailto:vdt@vaudejes.gov.al) ose në mediat sociale të projektit <https://www.facebook.com/vaudejestourismdestination/> ose Qendra e Promovimit të Konkurrueshmërisë [www.facebook.com/ccpalbania](http://www.facebook.com/ccpalbania)

### **Bashkia VAU DEJES**

Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejes

Email [vdt@vaudejes.gov.al](mailto:vdt@vaudejes.gov.al)

<https://www.facebook.com/vaudejestourismdestination/>

### **Qendra per Promovimin e Konkurrueshmerise**

Rruga "Durrësit" P.7, shk. 1 Ap. 1, Tirana, Albania

E-mail: [info@ccp.al](mailto:info@ccp.al)

Web: [www.ccp.al](http://www.ccp.al)



# 1. Hyrje

## 1.1. Sfondi i projektit

“Vau Dejës si destinacion turistik” është një projekt i financuar në kuadër të IPA 2022–BE për zhvillimin socio-ekonomik (si alternativë ndaj kultivimit dhe trafikimit të drogës) faza 2, nën thirrjen EuropeAid/173618/DD/ACT/AL, me numër Kontrate 434- 522

Qëllimi i projektit është zhvillimi i rajonit të VAU DEJES për të bërë një destinacion turistik tërheqës bazuar në komunitet përmes zhvillimit të infrastrukturës së informacionit turistik, ndërtimit të kapaciteteve dhe promovimit si një model i integruar dhe të qëndrueshëm për rritjen e numrit të turistëve që vizitojnë zonën, punësimin, biznese të reja dhe kontribuimin në një cilësi më të mirë të jetës për banorët vendas.

Objektivat specifike janë:

OS1: Përmirësimi i imazhit turistik të Vau Dejes përmes itinerareve turistike të reja, qasjes në informacion turistik dhe promovimit të turizmit.

OS2: Përmirësimi i shërbimeve turistike duke ndërtuar kapacitete dhe aftësi në profila turistike, mikpritje, artizanati dhe sipërmarrje.

OS3: Ndërtimi i kapaciteteve për personelin e Bashkisë për të kryer aktivitete të ndërgjegjshme ngritëse të komunitetit, planifikimin dhe hartimin e programeve dhe projekteve për zhvillimin e turizmit të Vau Dejës.

OS4: Përmirësimi i kapaciteteve në zbatimin e projekteve të BE-së dhe në dukshmërinë e tyre.

Rezultatet kryesore të projektit që janë arritur brenda vitit të parë të zbatimit janë:

### **Rezultati 1: Informacioni i përmirësuar turistik, sinjalistika turistike dhe promovimi i turizmit**

- ~ Është përmbledhur një inventar i burimeve natyrore, historike, kulturore, tradicionale, dhe të artizanatit
- ~ Janë vendosur 10 (dhjetë) tabela informuese turistike dhe përshkrimore në objekte të ndryshme të rëndësishme për vlerat turistike.
- ~ Janë vendosur 25 tabela udhëzuese turistike në pikat kryesore kryqëzore të zonës së Vau Dejes.
- ~ Janë përgatitur dhe vendosur 5 tabela me harta dhe foto të vendeve historike origjinale.

### **Rezultati 2: Zhvillimi i kapaciteteve në profilet e turizmit, mikpritja, zanatet, suvenire dhe sipërmarrje**

- ~ Rreth **75 persona** kanë marrë pjesë në trajnime për shërbimet e mikpritjes (kuzhinë, restorant, pastërti dhe menaxhim hoteli), sporte ujore dhe sipërmarrje.
- ~ **8 persona** janë në proces trajnimi për sportet ujore me kajak për të shërbyer si udhërrëfyes për sportet ujore.
- ~ **20** nxënës të shkollave të mesme të Bushatit dhe Hajmelit kanë marrë pjesë dhe janë trajnuar për stërvitjen për ecje në mal.
- ~ **40 persona** do të vazhdojnë të jenë pjesë e programit të sipërmarrjes, duke i orientuar ata drejt punës në vetëpunësim ose fillimit të një biznesi, si dhe janë mbështetur për të përgatitur planet e biznesit.
- ~ **10 artizanë** janë trajnuar për përgatitjen e suvenireve turistike.



- ~ **12** prodhues lokalë nga zona e Shllakut kanë ndjekur trajnimin për të përmirësuar produktet lokale në favor të turizmit.

### **Rezultati 3: Përmirësimi i aftësive të stafit të bashkisë për planifikimin, hartimin dhe menaxhimin e zhvillimit të programeve dhe projekteve për turizmin dhe organizimin e ndërgjegjësimit publik.**

Projekti do të rrisë kapacitetet e stafit të Bashkisë për të hartuar Planin e Veprimit për Turizmin në bashkësi dhe organizimin e aktiviteteve të ngritjes së ndërgjegjësimit me fokus në turizëm.

Një trajnim 4 ditor është ofruar për stafin e Bashkisë për tu aftësuar në draftimin e projekteve dhe programeve

Projekti hap thirrjen për aplikime për sipërmarrës të interesuar për të zhvilluar biznesin e turizmit dhe për të aplikuar dhe përfitur nga skema e nën-grantit. Ky udhëzues për ndarjen e granteve është përgatitur për të siguruar procedurat dhe orientimet për administrimin e skemës së grantit që do t'i ndahet sipërmarrësve të zonës së VAU DEJES.

#### **1.2. Informacion i përgjithshëm mbi skemën e nëngranteve**

"Skema e Granteve për Nismën Biznesore në Turizëm" është i financuar nga Bashkimi Evropian, dhe është projektuar për të mbështetur krijimin ose zgjerimin e veprimtarive të biznesit që kanë impakt në zhvillimin e turizmit në zonën e caktuar.

Shuma totale e financimit është **35,000 Euro**. Perfituesit do të përfshihen në një proces konkurrues. Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve synon të sigurojë transparencë dhe konkurrencë të drejtë, dhe të mbështesë idetë dhe planet më të mira të biznesit, ato që janë unike dhe të besueshme, që garantojnë rezultate të qëndrueshme.

Ky proces është ndihmuar nga ekspertë që janë angazhuar me aplikantët potencialë për të inkurajuar zhvillimin e ideve të tyre të biznesit duke ofruar trajnime se si të planifikojnë dhe zhvillojnë një plan biznesi, dhe duke ofruar mbështetje gjatë përgatitjes së planeve të tyre të biznesit.

#### **1.3. Objektivi i thirrjes për aplikime**

**Objektivi i skemës së grantit** është kontributi për zhvillimin e bizneseve/bizneseve sociale me impakt në zhvillimin e turizmit për fuqizimin ekonomik të grupeve të sipërmarrësve, që kontribuojnë në rritjen e punësimit të personave më vulnerabël dhe të rinjve në zonë, duke përmirësuar kapacitetet e shërbimeve turistike në zonën e Vau Dejës.



*Qëllimi kryesor* i thirrjes për aplikime është të ftohen sipërmarrësit që planifikojnë nisma të reja biznesi ose biznese ekzistuese të interesuara për zgjerimin e biznesit të tyre duke aplikuar dhe konkurruar me **idetë e tyre të biznesit, në fazën e fillimit ose zgjerimit të biznesit për mbështetje financiare përmes kësaj skeme granti.**

Rezultatet kryesore të pritura në këtë Thirrje për Aplikime janë:

- ❖ Minimumi 5-7 do të krijojnë dhe/zhvillojnë bizneset në fushën e turizmit.
- ❖ Një numër minimal prej 10-15 njerëzve nga grupet e vulnerabël dhe të rinjve nga zona do të punësohen.
- ❖ Bizneset do të synojnë zhvillimin e komunitetit të tyre lidhur me zhvillimin e turizmit.
- ❖ Ngritja e partneriteteve midis bashkisë dhe bizneseve private të turizmit për bashkëpunim reciprok.

## 2. Rregullat për Thirrjen për Aplikime

Këto udhëzime përcaktojnë rregullat për paraqitjen, përzgjedhjen dhe zbatimin e veprimeve të finansuara nën këtë thirrje.

### 2.1. Pranueshmëria e aplikantëve

Kontrata e Grantit është plotësisht e dedikuar bizneseve me status fitimprurës ose organizatave jofitimprurëse që konsiderojnë zhvillimin e një veprimtarie të vogël biznesi për të krijuar një stabilitet financiar që mundëson ofrimin më të mirë të shërbimeve të tyre turistike.

**Kriteret e ligjshme për Aplikuesit në këtë Thirrje janë:**

- Çdo entitet biznesi (fitimprurës) duhet të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit para hapjes së kësaj thirrjeje OSE në momentin e nënshkrimit së kontratës së Grantit DHE
- Personat juridikë, organizatat ose shoqatat jo fitimprurëse, por që operojnë si ndërmarrje sociale
- Biznese që operojnë në fushën e turizmit, mikpritjes dhe fushave relevante
- Biznese që veprojnë në territorin e Bashkisë së Vau Dejes DHE
- Janë drejtpërdrejt përgjegjës për zbatimin e planit/projektit të biznesit, dhe jo të veprojnë si ndërmjetës.

Disa kriteret për përzgjedhjen e subjekteve të përshtatshme për të marrë mbështetje financiare përfshijnë:

- **Kriteret Ekonomike:** Subjektet duhet të demonstrojnë një ide ose plan zhvillimi të qëndrueshëm bazuar në një analizë tregu, një plan marketingu të përcaktuar mirë, kapacitete organizative të forta, burime të disponueshme, ambiente të përshtatshme dhe



zinxhirë furnizimi të besueshëm. Po ashtu, këto subjekte duhet të jenë të vendosura brenda zonës së Bashkisë së Vau Dejës.

- **Kriteret Sociale:** Subjektet do të vlerësohen bazuar në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë financiare, impaktin social të mundshëm, me një fokus në përfitimin e individëve nga zonat rurale ose të larguara, familjeve të udhëhequra nga gra dhe të rinjve të papunë nga zonat rurale.
- **Pjesëmarrja në Trajnime:** Do të preferohen sipërmarrësit që marrin pjesë aktivisht në trajnimet e organizuara në kuadër të këtij projekti.

Këto kriteret synojnë të sigurojnë që subjektet e përzgjedhura jo vetëm kanë një bazë ekonomike të fortë, por gjithashtu kontribuojnë pozitivisht në aspektet sociale të Bashkisë së Vau Dejës. Theksimi në pjesëmarrjen në trajnime vë në dukje përkushtimin e projektit ndaj ndërtimit të kapaciteteve dhe suksesit afatgjatë të ndërmarrjeve të mbështetura.

### *Çdo aplikant do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit dhe grantit nëse:*

a) Është në faliment, nën ndonjë proces falimentimi apo likuidimi, pasuritë e tij po administratoren nga një likuidator ose nga një gjykatë, apo është në një marrëveshje me kreditorët, apo nëse veprimtaritë e tij biznesit janë pezulluar, ose ndodhet në ndonjë situatë analoge e shkaktuar nga një procedurë e ngjashme e parashikuar në ligjet ose rregulloret kombëtare;

b) Nëse nga një vendim final gjyqësor ose një vendim administrativ final është vendosur se aplikuesi ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesat e taksave ose kontributeve për sigurimet shoqërore, në përputhje me ligjin e vendit ku është i vendosur, me atë të vendit ku ndodhet Delegacioni i Komisionit Evropian, ose me atë të vendit ku kryhet kontrata;

c) Nga një vendim final gjyqësor ose një vendim administrativ final është vendosur se operatori ekonomik është fajtor për një moskryerje të rëndë profesionale duke shkelur ligjet ose rregulloret përkatëse ose standardet etike të profesionit ku aplikanti i përket, ose duke angazhuar veten në ndonjë sjellje të gabuar që ka një ndikim në kredibilitetin e tij profesional, kur kjo sjellje tregon një qëllim të gabuar ose pakujdesi të madh, duke përfshirë, në veçanti, cilëndo nga këto:

- Mashtrimi ose pakujdesia në paraqitjen e informacionit të nevojshëm për verifikimin e mungesës së arsyes për përjashtim ose përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes ose në kryerjen e një kontrate;
- Lidhja e marrëveshjeve me operatorë ekonomikë të tjerë me qëllim të deformimit të konkurrencës;
- Përpjekja për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes të Autoritetit Kontraktues gjatë procedurës së prokurimit;
- Përpjekja për të fituar informacion konfidencial që mund t'i ofrojë avantazhe të parregullta në procedurën e prokurimit.
- 

Nëse Bashkia e Vau Dejës bëhet e vetëdijshme për çdo situatë përjashtimi dhe këto pretendime konfirmohen, subjekti i përkatshëm do të përjashtohet nga procedura.

## 2.2 Shuma e grantit





Buxheti i përgjithshëm indikativ i cili do të jetë i disponueshëm në kuadër të kësaj Thirrje për Aplikime është **35,000 EURO**. Çdo grant i kërkuar në kuadër të kësaj Thirrje për Aplikime duhet të jetë në vlerë **nga 5,000 deri në 7,000 EURO**, për secilin plan biznesi të propozuar, i cili është pranuar gjatë procesit të përzgjedhjes.

Skema mbulon 100% të kontributit financiar të miratuar për shpenzimet e pranueshme.

Përmes kësaj Skeme Granti, projekti do të financojë **5-7 organizata** për propozimet e tyre të ideve të biznesit.

Aplikuesit mund të konsiderojnë një plan biznesi me nevojë kapitali më të lartë, por që ky financim shtesë do të mbulohet duke përdorur mjete financiare të tjera (grante nga donatorë të tjerë apo kontributin e tyre vetjak, kredi, etj.). Nëse instrumenti financiar do të përdoret së bashku me ndihmën e grantit për të nisur planin e biznesit, atëherë ky burim financimi duhet të përfshihet në planin biznesit dhe do të jetë subjekt i vlerësimit. Nëse një instrument financiar tjetër do të përdoret për zgjerimin e mëtejshëm të biznesit, ky benefit shtesë i mbështetur pritet të raportohet vetëm në vizitat dhe raportet e monitorimit.

Perioda e kërkuar e zbatimit **do të jetë 6 (gjashtë) muaj pas nënshkrimit të kontratës.**

Përfituesit e Grantit do të kenë edhe asistencë teknike nga 1 ekspert gjatë fazës së zbatimit të grantit.

### **2.3. Aktivitetet e pranueshme: aktivitete për të cilat mund të bëhet një aplikim**

Të gjitha veprimtaritë e propozuara në planet e biznesit të përshtatshme për mbështetje financiare duhet të jenë veprimtari që përfshihen brenda këtyre sektorëve të përcaktuar. Këto sektorë janë identifikuar për impaktin e tyre të konsiderueshëm në zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë, si më poshtë:

- Shërbimet e hosteleve, shtëpive të mysafirëve, hoteleve
- Ofrimi i shërbimeve turistike në sporte ujore, udhërrefyes turistik
- Ekonomitë krijuese (përfshirë artizanatin tradicional)
- Prodhimet lokale të realizuara në shtëpi ose me bazë brenda komunitetit

#### **Prioritet do të jepet aplikimeve që:**

- Kanë ide biznesi unike, (që nuk përsëriten brenda grupit të aplikuesve);
- Prezantojnë produkte/shërbime të reja brenda sektorëve të përmendur më lart;
- Janë biznese të lidhur ngushtë me komunitetet lokale;
- Krijojnë më shumë se 2 vende pune, veçanërisht nga grupet e përjashtuara ose krijojnë një impakt më të lartë për komunitetin.
- Kanë marrë pjesë në procesin e trajnimit dhe mentorimit për përgatitjen e planit të biznesit.

### **2.4. Kostot e Ligjshme**



**Kostot e përshtatshme** që do të mbështeten nga Skema e Grantit janë kostot reale të shpenzuara nga përfituesit dhe do të përdoren për zbatimin e planit të biznesit/projekteve në veprimet e mëposhtme:

- Pagat për stafin për një periudhë 3 mujore, në një maksimum të pagës neto mujore prej 35,520 ALL për 1 person dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punonjësit dhe punëdhënësit për një periudhë të maksimumit të tre muajve për një nivel pagash bruto 40,000 (11,160 ALL x 3 muaj), vetëm nëse është biznis fillestar
- Blerja e makinerive, mjetet dhe pajisjet, si dhe softuer, drejtpërdrejt të lidhur me prodhimin dhe/apo shërbimin;
- Blerja para fillimit të biznesit të lëndëve të para në rast kur ato janë shumë të rëndësishme për fillimin e biznesit (vetëm një herë).
- Blerja e materialeve për mobilimin ose organizimin e ambienteve/ndërtesave për biznesin (vetëm 30%, është e lejuar).

## 2.5 Kushte të tjera:

- Vlera e saktë e kontraktuar do të varet nga parashikimet financiare dhe kërkesa e çdo aplikanti për financim, e cila mund të ndryshojë nga ajo që është kërkuar në planin e biznesit
- Çdo shpenzim duhet të ndodhë brenda periudhës së marrëveshjes së kontratës.
- Asnjë kosto që nuk përdoret drejtpërdrejt për zbatimin e planit të biznesit/projektit nuk do të kthehet.
- Kostot janë të identifikueshme dhe verifikueshe, veçanërisht duke u regjistruar në dokumentacionin e llogarive të përfituesit.
- Shpenzimet përputhen me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm tatimor dhe social;
- Tatimi i Shtuar i Vlerës (TVSH) nuk konsiderohet si një kosto e përshtatshme në këtë Thirrje për Aplikime.

Një rregullore specifike do të vendoset për raportimin përfshirë deklarimi i faturave, kontratat dhe një raport i paraqitur pas periudhës së 3 muajve të zbatimit të granteve dhe pas 6 muajve të zbatimit.

## 3. Si të aplikoni dhe procedurat që duhen ndjekur

Aplikimet duhet të dorëzohen duke përdorur Formularin e Aplikimit.

Këto dokumente duhet të përmbajnë TË GJITHA informacionet e rëndësishme lidhur me Aplikimin dhe nuk duhet të dërgohen anekse shtesë. Çdo gabim i konsiderueshëm në lidhje me këtë Udhëzues për Aplikantët dhe dokumentet e kërkuara mund të çojë në refuzimin e aplikacionit.

### Lista e dokumenteve të nevojshme për Kontrollin Administrativ

Aplikantët duhet të dërgojnë listën e dokumenteve të përmendura më poshtë:

1. NIPT/ose deklaratë për regjistrim para nënshkrimit të kontratës
2. Statuti i organizatës dhe ndonjë ndryshim i mundshëm në statut (vetëm për organizatat);



3. Dokument nga Departamenti i Taksave që dëshmon se biznesi/organizata nuk ka obligime financiare të pavlefshme, si obligimet shoqërore, shëndetësore ose tatimore - lëshuar para periudhës së mbylljes së Thirrjes;
4. Bilanci për entitetet që operojnë më shumë se një vit;
5. Plotësimi i modelit të planit të biznesit/projektit të dhënë nga Autoriteti Kontraktues.
6. Plotësimi i modelit të kërkesës për grant

Ju lutemi të keni parasysh se nëse aplikantët nuk plotësojnë të gjitha kërkesat dhe nuk mund të dorëzojnë të gjitha dokumentet e përmendura më lart, atëherë aplikacioni do të refuzohet automatikisht.

Propozimet duhet të përgatiten në **gjuhën shqipe**.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në një zarf ku të shkruhet. "Të mos hapet përpara procesit të vlerësimit" në adresën e mëposhtme:

Bashkia Vau Dejes, Zyra e Protokollit

Rr."Qafa e Gurit" Vau Dejes

Një kopje elektronike e aplikimit (vetëm dokumentet e mësipërme nr. 5 dhe 6) do të dërgohet me email në adresën: [vdt@vaudejes.gov.al](mailto:vdt@vaudejes.gov.al)

### 3.1. Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve

Njoftimi aktual i kësaj Thirrjeje për Aplikime është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë [www.vaudejes.gov.al](http://www.vaudejes.gov.al) në rrjetet sociale të projektit <https://www.facebook.com/vaudejestourismdestination/> dhe në profilet facebook të Qendrës për Promovimin e Konkurrencës <https://www.facebook.com/ccpalbania/>

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data 5 Prill 2024, deri në orën 16:00.**

Çdo aplikacion i dorëzuar pas afatit do të refuzohet.

Pyetjet mund të dërgohen nëpërmjet emailit jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë para afatit të dorëzimit të aplikacionit në adresat e mësipërme dhe emaili duhet të tregojë qartë titullin e Thirrjes për Aplikime:

**"Aplikacioni - Vau Dejes si Destinacion Turistik."**

Autoriteti Kontraktues nuk ka detyrimin të japë sqarime për pyetjet e dërguara pas kësaj date. Përgjigje do t'u jepet jo më vonë se 7 ditë para afatit të dorëzimit të aplikacioneve.

Për të siguruar trajtim të barabartë të aplikuesve, Autoriteti Kontraktues nuk mund të japë një mendim paraprak lidhur me përshtatshmërinë e aplikuesve, një veprimi ose aktiviteti të caktuar

### 4. Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikacioneve

Pikët maksimale për çdo aplikim janë 100. Çdo seksion ka kritere të ndryshme dhe vlerësim të ndryshëm me pikë.



<b>Tabela e Vlerësimit - Kriteret</b>	<b>Rezultati maksimal</b>	<b>Rezultati mesatar</b>
<b>1. Kapaciteti Financiar dhe Operative</b>	<b>15</b>	
1.1 Aplikanti ka përvojë dhe eksperiencën e mjaftueshme në fushën e turizmit dhe mikpritjes ose fushave të tjera relevante?	5	
1.2 Aplikanti ka kapacitetet financiare të mjaftueshme për të filluar dhe/ose zbatuar biznesin?	5	
1.3 Aplikanti ka kapacitetet e mjaftueshme menaxheriale, përfshirë personelin, makinerinë, pajisjet, mjetet, ambiente, furnizuesit për të zbatuar idenë e biznesit?	5	
<b>2. Relevanca 25</b>	<b>25</b>	
2.1.Sa e lidhur është ideja e biznesit me qëllimin dhe një ose më shumë prioritetet e përcaktuara në thirrjen publike? (a është prezantuar një ide unike biznesi? A janë prezantuar produkte/shërbime të reja në sektor?)	5	
2.2.A janë përcaktuar qartë nevojat e klientëve dhe a i adreson projekti ato në mënyrë adekuate?	5	
2.3.A përfshin projekti vlerë të shtuar, si qasje inovative dhe modele praktikash të mira?	5	
2.4. A ndikon ideja e biznesit/projekti grupe të ndjeshme: të rinjtë, gratë?	5	
2.5.A ndikon ideja e biznesit/projekti në mbrojtjen e mjedisit?	5	
<b>3. Metodologjia</b>	<b>20</b>	
3.1. A korrespondon plani i marketingut dhe plani i veprimit i propozuar në mënyrë logjike dhe praktike me fushën e veçantë të biznesit?	5	
3.2.Sa konsistent është përgjithësisht propozimi? A reflekton analizën e klientëve/komunitetit dhe nevojat e tyre?	5	
3.3. A përgjigjet plani i marketingut, përfshirë produktin, çmimin, shpërndarjen dhe promovimin, në mënyrë specifike ndaj rezultateve të pritshme të biznesit/projektit?	10	
<b>4. Qendrueshmëria</b>	<b>20</b>	
4.1. A do të ketë projekti efekte në punësimin e të paktën 2 personave?	5	
4.2 A janë rezultatet e pritshme të qëndrueshme në terma të mbulimit financiar? A do të krijojë investimi një stabilitet financiar të qëndrueshëm për të siguruar më mirë shërbimin turistik të mbështetur nga projekti përtej jetëgjatësisë së projektit?	10	
4.3. A është e mundur që rezultatet e dëshiruara në terma afatgjata të ndikojnë në turizmin lokal, kushtet ekonomike dhe/ose cilësinë e jetës në zonat e synuara?	5	
<b>5. Buxheti dhe Efikasiteti i Kostos</b>	<b>20</b>	
5.1 A është raporti midis kostos të parashikuar dhe rezultateve të pritura i kënaqshëm?	5	
5.2 A janë kostot e sugjeruara të nevojshme për zbatimin e projektit/planit të biznesit?	5	
5.3. A është buxheti i qartë dhe përfshin shpjegime të mjaftueshme për pajisjet teknike? A reflekton kostot reale të tregut dhe siguron efikasitet të kostos së veprimit?	10	
<b>Pikët totale Maksimale</b>	<b>100</b>	

#### 4.1. Hapat dhe kriteret

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit i përbërë nga përfaqësuesit e Bashkisë, organizatat zbatuese dhe vlerësuesi i jashtëm. Të gjitha aplikacionet do të vlerësohen sipas hapave dhe kriterëve të mëposhtme.

#### HAPI 1: Hapja dhe vlerësimi i kontrollit administrative



This Project is financed by the European Union

Gjatë hapjes dhe kontrollit administrativ, do të vlerësohet:

- Nëse është respektuar afati i dorëzimit. Në të kundërt, aplikimi do të refuzohet automatikisht.
- Nëse ndonjë nga dokumentet e kërkuara për aplikim mungon ose është e pasaktë, aplikimi do të refuzohet automatikisht vetëm bazuar në këtë fakt dhe nuk do të vlerësohet më tej.

Pastaj aplikimet që kalojnë kontrollin e përshtatshmërisë do të vlerësohen më tej për aspektet teknike të propozimit.

## **HAPI 2: Vlerësimi përfundimtar**

Aplikantët që kanë marrë vlerësimin më të mirë dhe pikët më të larta do të shpallen fitues nga Autoriteti Kontraktues, bazuar në një listë renditëse që rezulton nga:

- Vlerësimi administrativ i propozimit
- Vlerësimi i planit të propozuar të biznesit/projektit

Raporti përfundimtar i Vlerësimit, duke përfshirë rezultatet e mësipërme, do të përgatitet dhe do të nënshkruhet nga çdo anëtar i komisionit të vlerësimit. Komisioni i Vlerësimit do të propozojë shumën e nevojshme të granteve për t'u ndarë çdo fituesi, duke analizuar buxhetin e planit të biznesit për të:

- Siguruar efikasitet të kostos së veprimit;
- Siguruar një balancë të drejtë mes kostove operative dhe atyre jo operative;
- Reflektuar kostot reale të tregut;
- Reflektuar kostot në përputhje me buxhetin e propozuar.

## **HAPI 3: Faza e negocimit dhe kontraktimit**

Autoriteti Kontraktues, para nënshkrimit të kontratës, rezervon të drejtën për të biseduar me aplikantin dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar shumën e grantit të kërkuar për çdo aplikim, bazuar në vendimin e Komisionit të Vlerësimit për kostot e nevojshme për zbatimin e planit të biznesit/projektit. Pikat e negocimit nuk duhet të ndryshojnë në asnjë mënyrë pjesën substanciale të veprimtarisë së propozuar.

Pas arritjes së një marrëveshjeje, kontrata e grantit do të nënshkruhet midis aplikantit të përzgjedhur dhe Bashkisë së Vau Dejes.

## **5. Njoftimi i vendimit të Autoritetit Kontraktues**

### **5.1. Përmbajtja e vendimit**

Aplikantët do të informohen përmes email-it për vendimin e Autoritetit **Kontraktues (Bashkisë)** lidhur me vlerësimin e aplikimin e tyre. Për të siguruar transparencë të plotë, emrat e fituesve do të publikohen në mediat sociale të projektit.



## **6. E drejta për ankim (procedurat e ankimit gjatë vlerësimit të veprimeve të propozuara)**

Aplikanti do të informohet me shkrim (postë të rregullt dhe/ose email) nëse është refuzuar, dhe do t'i jepen arsyet për refuzimin. Pa bërë paragjykim, nëse një aplikant mendon se është prekur negativisht nga ndonjë gabim ose parregullsi e pretenduar e kryer si pjesë e procedurës së përzgjedhjes, ose nëse procedura ka pasur probleme që mendoni se janë keqkuptuar apo keqpërdorur, kërkesa për informacion shtesë dhe/ose ankesa duhet të bëhen në formë shkrimi përmes emailit/postë brenda 5 (pesë) ditëve nga dita kur është pranuar emaili i njoftimit për refuzim.

## **7. Kushtet për zbatimin pas vendimit të autoritetit kontraktues për dhënien e grantit**

Pas vendimit për marrjen e grantit, fituesit do t'u ofrohet një kontratë bazuar në kontratën standarde të grantit. Duke nënshkruar Kontratën, aplikanti pranon kushtet kontraktuale të kontratës standarde të grantit.

## **8. Lista e dokumenteve dhe anekseve përkatëse**

Të gjithë Aplikantët në këtë Thirrje duhet të referohen në dokumentet e mëposhtme:

- i) Udhëzues për aplikim granti me tabelën e vlerësimit (Ky dokument)
- ii) Paketa e Aplikimit (Formularin e Planit të Biznesit)
- iii) Formulari I përdorimit të Grantit
- iv) Lista e dokumentave shoqërues



**FORMULAR**  
**PER**  
**PLAN BIZNESI**

Muaji MARS 2024

## **UDHEZUES**

*Në formatin e mëposhtëm për çdo paragraf jepet një përshkrim i shkurtër me udhëzime për t'ju orientuar sa më drejt në kryerjen e analizave të nevojshme me qëllim që të përgatitni një plan propozimi sa më të përafshur me realitetin.*

***Në përfundim të planit ju mund ti hiqni te gjitha pjeset udhëzuese të këtij formati.***

### **0. TË DHËNAT PERSONALE TË APLIKANTIT**

Emri, Mbiemri	
Emri i Kompanisë (nëse jeni në biznes)	
Adresa:	
Tel.:	
E-mail:	
Dita e fillimit të biznesit	
Forma ligjore	

### **I. PERMBLEDHJE E SHKURTËR E PLANIT**

Përmbledhja ekzekutive plotësohet në fund, pasi të jenë plotësuar të gjitha seksionet. Nuk duhet të jetë më e gjatë se ½ deri në 1 faqe. Kjo është pjesa që do të lexohet më shumë

- Një paragraf që përshkruan idenë tuaj të biznesit (përcaktimi i misionit dhe qëllimi specifik i planit)
- Procesin e dizinimit dhe prodhimit të produkteve
- Strategjia e marketingut (imazhi i biznesit, cilët janë klientët dhe si do tërhiqen ata)
- Personeli (kush është pronari dhe përgjegjës për menaxhimin)
- Një përmbledhje të shkurtër të parashikimeve financiare
- Përmbledhje se si do të kryhet financimi

### **2. PROFILI I SIPERMARRSIT /PROFILI I KOMPANISE**

**NËSE JENI SIPËRMARRËS I RI**, që nuk jeni akoma në biznes, lutemi bëni një përshkrim të aftësive tuaja, që ju bëjnë të mendoni se jeni të aftë për të kryer këtë biznes:

**NËSE E KENI HAPUR BIZNESIN**, lutem bëni një përshkrim të biznesit tuaj



### 3. PRODUKTET/SHËRBIMET

Lutemi bëni një përshkrim të produktit/ëve dhe /ose shërbimit që do të ofroni në treg. Është e rëndësishme që të keni të qarta llojet e ndryshme të produkteve që do të ofroni (ose që planifikoni të ofroni), pasi kjo është e lidhur me seksionet e tjera të planit, dmth me identifikimin e klientëve apo përcaktimin e segmentit të tregut ku do të shërbeni. Në rast se jeni në biznes, plani duhet të përfshijë edhe produktet e tjera që ju keni aktualisht. Listimi i produkteve duhet bërë i veçantë, pasi ato mund të lidhen me tipe të ndryshme klientësh dhe me nevoja të ndryshme.

**Produkti 1 :** Jepni informacione

**Produkti: 2**

### 4. ANALIZA E TREGUT

#### 4.1 Nevojat e Tregut

Jepni arsyet pse po hyni në treg me produktet tuaja.

#### 4.2. Madhësia dhe Lokalizimi i tregut

Lokalizimi i tregut dhe madhësia e tij duhet të përcaktohen bazuar në të dhëna, statistika, informacione nga pikat e shitjes, nga përfaqësuesit e shitjeve, apo njëri të tjerë që kanë njohuri mbi këtë treg, si edhe direkt prej konsumatorëve.

#### 4.3 Klientët dhe pritjet e tyre

Identifikoni cilat janë tiparet karakteristike të klientëve tuaj, pozicionin gjeografik (pra ku banojnë klientët tuaj), si dhe të dhëna demografike në lidhje me ta.

#### 4.4 Analiza e konkurrencës

Si do të hyni ju në treg? Me disa produkte? Në një zonë të caktuar dhe me klientë të përcaktuar? Cilat produkte dhe kompani konkurrojnë me ju?

Listoni emrat dhe adresat e konkurrentëve tuaj kryesorë. Shënoni në tabelë në cilat nga këto elementë jeni më të fortë ose më të dobët ju dhe konkurrentët tuaj.

Elementët e analizuar	Kompania juaj		Konkurrenti A		Konkurrenti B	
	Pikat e Forta	Pikat e Dobëta	Pikat e Forta	Pikat e Dobëta	Pikat e Forta	Pikat e Dobëta
Produktet						
Çmimi						
Cilësia						
Shërbimi						

Elementët e analizuar	Kompania juaj		Konkurenti A		Konkurenti B	
	Pikat e Forta	Pikat e Dobëta	Pikat e Forta	Pikat e Dobëta	Pikat e Forta	Pikat e Dobëta
Paketimi						
Shpërndarja						
Pjesa e tregut						
Pozicionimi në treg						
Pikat e shitjes						
Metodat e shitjes						
Reklama						
Imazhi i biznesit						

## 5. PLANI I MARKETINGUT

*Në këtë pjesë të planit duhet të jepni informacion mbi marketingun dhe veprimet në kuadër të planit të marketingut.*

### 5.1 Produkti

### 5.2 Çmimi

*Jepni informacion duke shpjeguar metodën e vendosjes së çmimeve të produkteve të reja. Për bizneset e vogla, mbajtja e çmimit të ulët nuk është një politikë e mirë.*

### 5.3 Shpërndarja e Produkteve/Shërbimeve

*Duhet të jepet informacion se si do të shiten në treg produktet/shërbimet tuaja*

### 5.4 Promocioni

*Plani i promocionit duhet të mbajë parasysh çështjet që lidhen me imazhin e biznesit. Sepse krijimi i një imazhi pozitiv do të tërheqë klientët që synoni.*

### 5.5 Plani i buxhetit të marketingut

*(Lutem vendosni në tabelë veprimtaritë që kanë lidhje me idenë tuaj të biznesit Sa lekë do të shpenzoni për marketingun që keni përshkruar më lart?)*

## 6. MANAXHIMI DHE ORGANIZIMI

*Shpjegoni veprimtarinë e përditshme të biznesit, vendndodhjen, pajisjet, personeli, proceset, burime të tjera, etj.*

### 6.1 Vendndodhja, personeli, furnitorë

## 6.2 Makineri dhe pajisje, mobilje, mjete transporti

*(Lutemi përshkruani të gjitha pajisjet që ju nevojiten për fillimin e punës. Për vlerësimin e çmimit duhet të merrni ofertat për secilën prej tyre. Lutemi plotësoni të dhënat e kërkuara në tabelën e mëposhtme)*

## 6.3 Forma ligjore e biznesit dhe dokumentacioni

*(Lutemi përshkruani formën ligjore të kompanisë psh. Person fizik apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k)?)*

## 6.4 Burimet e financimit

Nr.	Përshkrimi i financimit	TOTALI NE LEKE
1	Financim nga Granti	
2	Kontributi i vet aplikantit	
3	Burime të tjera financiare	
	<b>TOTALI I BURIMEVE TE FINANCIMIT NE LEK</b>	

## 7 PLANI I VEPRIMIT

*Lutem bëni një plan të thjeshtë se si do t'i parashikoni veprimet në të ardhmen. Ndryshojeni sipas rastit tuaj.*

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	PERIUDHA	PËRGJEGJËSI
Regjistrimi i kompanisë (në QKR ose gjykatë)		
Marrja e Licensës (nesë kërkohet)		
Blerja apo marrja me qera per ndërtesën		
Blerja e pajisjeve		
Rekrutimi dhe kontratat me personelin		
Nenshkrimi i kontratave me furnitorët dhe beresit		
Te tjera		

## 8. PLANI FINANCIAR

*(Keto llogaritje dhe tabela rekomnadohet te pergatiten ne format exceli per lehte llogaritjesh)*

Tabela 1 INVESTIMET NE MAKINERI DHE PAJISJE				
Nr.	Emri i makinerise/pajisjes	Sasia	Çmimi për njësi në Lekë	Kosto Totale në Lekë
1.	Toka dhe Ndërtesa			
2.	Makineri dhe Pajisje			
3.	Mjete transporti			
4.	Mobilje			
5.	Ndërtime dhe rikonstruksione			
6.	Të tjera			
	<b>TOTALI në LEKE</b>			



7	Telefon +Internet													
8	Materiale zyre /administrative													
9	Reklama /Marketing													
10	Pagesa për mbajtjen e kontabilitetit													
11	Pagesa pajisje me qira													
12	Pagesa për mjete transporti													
13	Siguracione makine													
14	Taksat bashkie/akciza													
15	Kosto te tjera													
<b>D.</b>	<b>TEPRICA/ DEFICITI (B-C)</b>													
<b>E.</b>	<b>GJENDJA NE FUND TE PERIUDHES (A+B-C)</b>													

Emri Mbiemr

<b>TABELA 4: PARASHIKIMI I HUMBJE/ FITIMIT PER NJE PERIUDHE 3-VJECARE</b>			
<b>Vitet</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>	<b>2026</b>
Te ardhurat nga xhiro			
Kosto e mallrave te blera			
Shpenzimet operacionale			
<b>Totali</b>			
Amortizimi nese ka			
<b>Fitimi para taksave</b>			
Tatimi mbi fitimin 0% ose/15%			
<b>Fitimi neto</b>			

FEmri/Mbiemri (Firma)

**TABELA E PËRDORIMIT TË GRANTIT**

Lutemi jepni përshkrim të detajuar për secilin shpenzim që kërkoni të mbulohet nga granti

Tabela 5. TABELA E PËRDORIMIT TË GRANTIT SIPAS MUAJVE								
	AKTIVITETET	MUAJT						Totali në Lek
		1	2	3	4	5	6	
1	/Riparim/Konstruksion							
2	Makineri, pajisje, software, etj							
3	Blerja fillestare e lëndëve të para ose produkte							
4	Paga neto per 3 muaj							
5	Sigurimet e punëdhënësit per 3 muaj							

Emri Mbiemri  
Firma



Funded by  
the European Union



## **LISTA E DOKUMENTEVE**

### **Procesi i aplikimit**

1. Udhëzues për aplikim granti me tabelën e vlerësimit
2. Paketa e Aplikimit (Formularin e Planit të Biznesit)
3. Lista e dokumenteve shoqërues të aplikimit (si më poshtë)

### **Dokumentet e Kërkuara**

1. NIPT/ose deklaratë për regjistrim para nënshkrimit të kontratës
2. Statuti i organizatës dhe ndonjë ndryshim i mundshëm në statut (vetëm për organizatat);
3. Dokument nga Departamenti i Taksave që dëshmon se biznesi/organizata nuk ka obligime financiare të pavlefshme, si obligimet shoqërore, shëndetësore ose tatimore - lëshuar gjatë periudhës së Thirrjes;
4. Bilanci për entitetet që operojnë më shumë se një vit;
5. Plotësimi i modelit të planit të biznesit/projektit të dhënë nga Autoriteti Kontraktues.
6. Plotësimi i modelit të kërkesës për grant



Bashkia Vau Dejës  
Municipality of Vau Dejës  
Adresa: Rruga " Qafa e Gurit" Vau Dejës.  
Mob: 069 5813755  
E-mail: [info@vaudejes.gov.al](mailto:info@vaudejes.gov.al)  
Web: [www.bashkiavaudejes.gov.al](http://www.bashkiavaudejes.gov.al)



Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë  
Centre for Competitiveness Promotion  
Adresa: Rruga "Durrësit", P.7, Shk.1/1 .  
Mob: 069 2141920  
E-mail: [info@ccp.al](mailto:info@ccp.al)  
Web: [www.ccp.al](http://www.ccp.al)